Kronikë

Kamëz/ Qarkullonte i armatosur me makinë, 'Flagranca' prangos 28-vjeçarin, nën hetim edhe shoku i tij pasagjer (VIDEO)

Patrulla "Shqiponja" kishte marrë sinjalizime se dy të rinjtë qarkullonin të armatosur në rrugën "Zyrih". Të rinjtë tentuan t'i shmangeshin kontrollit duke parkuar larg nga postblloku, por pa sukses. Sekuestrohet arma, 21-vjeçari ndiqet në gjendje të lirë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
25 Janar, 15:22 | **Përditesimi: 25 Janar, 16:16**

Share

Tiranë- Qarkullonin të armatosur me makinë, "Flagranca" çon në pranga një 28-vjeçar dhe nën akuzë shokun e tij pasagjer.

Aksioni është kryer nga forcat "Shqiponja" të kryeqytetit, ndërsa u sekuestrua një armë zjarri pistoletë, që mbahej pa leje.

Efektivët kishin siguruar informacione paraprake se D. A., qarkullonte me automjet dhe mbante armë zjarri me vete, duke shfaqur rrezikshmëri të lartë shoqërore.

LEXO EDHE:
Tiranë/ Sërish zjarr në pallatet e kompleksit 'Kika' te 'Komuna e Parisit'! Merr flakë garazhi, zjarrfikësit evakuojnë banorët, mes tyre fëmijë! (VIDEO)

> *"Si rezultat i veprimeve operacionale, në rrugën "Zyrih" Kamëz, u bë kapja e shtetasit D. A., 28 vjeç, banues në Tiranë", bëri me dije policia.*

Kur i riu ka parë patrullat në rrugë, ai parkoi mjetin anash dhe ka qëndruar brenda bashkë me mikun e tij 21-vjeçar, për t'iu shmangur kontrollit. Por me të dhëna paraprake për ta, blutë i shkuan deri në fund verifikimit dhe brenda makinës gjetën edhe armën e zjarrit, që u sekuestrua si provë materiale.

Më tej arrestimi u krye nga Komisariati nr. 5 Kamëz, ku dhe është paraburgosur 28-vjeçari, në pritje të masës së gjykatës, për veprën penale "mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Në gjendje të lirë u procedua dhe A. D., 21 vjeç, i cili u gjet brenda në mjet, për veprën "moskallëzim krimi". Hetimet e mëtejshme për rastin i kaluan prokurorisë së kryeqytetit.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: arrestohen | armembajtje pa leje | kamez | Shqiponjat | Tirane

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet të votojnë emigrantët që kanë vetëm dokumente identifikimi të huaja?

25 Janar, 13:37

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

'Giro d'Italia' në Tiranë, Veliaj pret Presidentin e Federatës Evropiane të Çiklizmit: Do shkëlqejmë sërish! Enrico Della Casa: Tirana, në rrugën e duhur

25 Janar, 17:06

Tiranë/ Shpërndante kokainë dhe hashash në zonën e "Astirit", arrestohet 29-vjeçari! Një pjesë e drogës gjendet në biznesin e tij (VIDEO)

25 Janar, 17:00

Tiranë/ I shpallur në kërkim nga Italia për pjesëmarrje në organizatë kriminale, arrestohet 40-vjeçari

25 Janar, 15:31

Vdekja e 12-vjeçarit, nëna e Leo Sadikut me lot në sy kërkon drejtësi! Mjekët e morën në qafë, e trajtuan vetëm për virozë

Armand Braho

25 Janar, 15:22

Vendimi me propozim e firmë të saj! Balluku merr në dorë lejet e ndërtimit në Tiranë (plus 5 bashki) Për çdo ndërtim 15 km nga aeroporti, leje edhe nga Aviacioni! Kjo praktikë, në asnjë shtet tjetër

Redaksia investigative

25 Janar, 09:59

Vrasja e postierit në Kamëz, zbulohet sherri për prona me të skeduarin Ervis Lami, ('truri' i arrasisjes së Drenovës) I gjendet pistoletë me slienciator

Sokol Dema

25 Janar, 09:49

Kukës/ Qarkullonte me kokainë dhe hashash në makinë, 'Shqiponja' prangos 24-vjeçarin

24 Janar, 17:17

Tiranë/ Edukatorja dhunoi 3-vjeçarin, në hetim bashkëshorti i saj pasi kërcënoi babanë e të miturit

24 Janar, 16:23

'Dhurata' e parë për Shkëmbin, Tirana prezanton mbrojtësin argjentinas

24 Janar, 15:24

Tiranë/ Shisnin kanabis dhe kokainë, arrestohen dy të rinjtë! Policia sekuestron edhe 10 mijë euro (EMRAT)

24 Janar, 14:53

Gjyqi për zhdukjen dhe rrëmbimin e Jan Prengës, Dritan Rexhepi në GJKKO! Seanca shtyhet se mungoi një avokat

24 Janar, 14:01

Transferta në Ballsh, Bledi Shkëmbi i Tiranës: Kemi katër mungesa, pse u binda të rikthehem në ekip

24 Janar, 13:55

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje